



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

---

Në bazë të nenin 79 të Ligjit nr. 06/1 - 114 për Zyrtarët Publikë, nenit 8 të Ligjit të Punës nr.03/L-212, neni 7 të Rregullores (QKR)NR.05/2022 për Procedurat Konkurruese dhe Pranimit për Nëpunësit Administrativ dhe Mbështetës, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, shpall:

**K O N K U R S**

Pozita: **Nëpunës/e Administrativ/e**, 1 (një vend pune )

Referenca:

Paga: Klasa I-20 Koeficienti: 3.88

Kohëzgjatja e kontratës: Me afat të pacaktuar, periudha provuese gjashtë muaj.

I përgjigjet: Sekretarit të përgjithshëm ne KPMSHCK

Vendi: Prishtinë

**Detyrat kryesore:**

1. Siguron mbështetje të përgjithshme teknike dhe administrative përfshirë postën zyrtare, telefonatat, skanimin, kopjimin e dokumenteve, korrespondencën hyrese dhe dalese që është me rendësi për shqyrtim në zyrën e Sekretarit i Përgjithshëm;
2. Përgatit dhe modifikon dokumentet duke përfshirë korrespondencën, raportet, memorandumet agjendat dhe e-malet sipas kërkesës dhe rekomandimeve të eprorit;
3. Pranon dhe shpërndan korrespondencën e cila i drejtohet zyrës së drejtuesit të lartë si dhe kujdeset për mirëmbajtjen e saj;
4. Ruan dhe mirëmban sistemin elektronik dhe kopjet fizike të dokumenteve dhe dosjeve të Këshillit, mbajtja në rregull e librit të protokollit dhe librave tjera zyrtare;
5. Menaxhon kalendarin e takimeve dhe organizimeve të Këshillit;
6. Përgatitjen e proces-verbaleve të takimeve në mes të drejtorit dhe palëve të tjera;
7. Kryen edhe detyra ne rast të vëllimit të punëve në arkiv, protokoll në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

### **Kandidatet që aplikojnë duhet t'i përmbushin këto kritere:**

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojnë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik;
- Të ketë të përfunduar shkollimin e mesëm;

### **Dokumentacioni për aplikim duhet te përmbajë:**

- Formularin e aplikimit;
- Kopjen e diplomës për arsimin e mesëm, ndërsa për kandidatet që kane kryer shkollimin jashtë vendit, kopja e diplomës e notifikuar;
- Certifikatën e lindjes;
- Vërtetim nga gjykata që nuk është nën hetime
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Dëshmi për kualifikimet tjera

**Shënim:** Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve: Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Njësia e Burimeve Njerëzore, Sheshi Nëna Terezë « Ish–Ndërtesa e Gërmis» kati i II – të, nr.C-214 , Prishtinë, Kosovë;

**Për informata të hollësishme mund të kontaktoni zyrën e Burimeve Njerëzore në, tel: 038-211-673/ prej orës 08:00 – 16:00.**

Data e publikimit (njoftimit)të konkursit ne portalin shtetëror [www.konkursi.rks-gov.net](http://www.konkursi.rks-gov.net) është prej datës 16.05.2023ndërsa konkursi është i hapur për aplikim tetë (8) ditë, përkatësisht **nga data31/05/2023 deri me 07/06/2023.**

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrin brenda 4 ditësh, aplikacionet që arrin pas këtij afati dhe ato të pakompletuara refuzohen.

Kandidatët të cilët hyjnë ne përzgjedhje të ngushtë, do te njoftohen për vendin, datën dhe kohen e mbajtjes së intervistës me gojë nga Njësia e Burimeve Njerëzore, nëpërmjet telefonit ose me shkrim. Kandidatet të cilët do te jene të përzgjedhur dhe të ftuar në intervista, duhet të sjellin për konfirmim të gjitha dokumentet origjinale. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit te parapare nuk pranohen ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.